



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 16.12.2025.

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 09.12.2025, të parashtruar nga Grupi i Operatorëve ekonomik N.SH.T. VIKTORY COM; Companya Eskavatori SH.P.K; Marisa SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i Rugës X”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-397-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-003 -511, nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Grupit të Operatorëve ekonomik N.SH.T. VIKTORY COM; Companya Eskavatori SH.P.K; Marisa SH.P.K, e dt.09.12.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i Rugës X”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-397-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-003 -511, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 05.12.2025, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: **05.12.2025**;

3.Autoriteti Kontraktues, vendos që të anuloj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Grupi i Operatorëve ekonomik N.SH.T. VIKTORY COM; Companya Eskavatori SH.P.K; Marisa SH.P.K, me dt.09.12.2025, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me

aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i Rrugës X”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-397-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-003 -511.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 16.12.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimet tuaja se Autoriteti kontraktues ka bërë shkelje duke anuluar këtë aktivitet të prokurimit, nuk qëndron, sepse shkelje do të ishte po të vazhdonte me procedurat e prokurimit për këtë aktivitet pas njoftimit nga Njësia e kërkesës (Drejtoria për Infrastrukturë), ZKA dhe ZKF se ky projekt nuk është përfshirë në buxhetin e vitit aktual dhe të dy viteve tjera pasuese;

Sa ju përket vendimeve të OSHP-së, pretendimi juaj për mosrespektimin e vendimeve në fjalë nga ana e Autoritetit kontraktues nuk qëndron. Autoriteti kontraktues çdo herë duke respektuar këto vendime ka kthyer lëndën në rivlerësim dhe e ka njoftuar OSHP-në.

Autoriteti kontraktues është detyruar që të bëjë anulimin e këtij aktiviteti, sepse në të kundërtën do të vepronte në kundërshtim me:

- **nenin 8 paragrafi 8.5**, të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, sipas të cilit:

“ Personat përgjegjës për nënshkrimin e kontratës dhe DNPDP janë të obliguar që para publikimit të Formularit B58 “Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues”, të rikonfirmojnë që informatat financiare (DNPDP) nuk kanë ndryshuar “

- **nenin 8, paragrafin 8.1**, të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, sipas të cilit:
sipas të cilit :

“ Përcaktimi i nevojave dhe disponueshmërisë së fondeve nga ana e Autoriteteve kontraktuese bëhet në pajtueshmëri me Nenit 9 të LPP-së. Nëse AK është autoritet publik ose organizatë buxhetore ZKF do të siguroj që:

a. Fondet janë alokuar; ose

b. Fonde të mjaftueshme do të alokohen në vitin fiskal në fjalë. Kjo dispozitë do të përfshihet në kontratën publike. “Alokimi”do të thotë këtu “shuma është autorizuar”, në mënyrë që të jetë në përputhje me buxhetin dhe sistemin e pagesave. Qëllimi i sigurimit të fondeve të alokuar është që të përmirësohet efikasiteti, pasi që inicimi i një procedure të prokurimit për të cilën nuk ka fonde të alokuar thjesht mund të jetë humbje e resurseve. “

dhe

nenin 22, paragrafi 22.1 të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, sipas të cilit :

“ Për çdo aktivitet të prokurimit të autoritetit kontraktues, ZKA duhet të caktojë një person që të shërbejë si Zyrtar Autorizues për atë aktivitet të prokurimit. Gjatë caktimit të Zyrtarit Autorizues, ZKA duhet të përmbush të gjitha kushtet e parapara në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë si dhe në Rregullat Financiare të shpallura nga Thesari. Zyrtari Autorizues nuk e autorizon Zyrtarin e Prokurimit që të iniciojë aktivitetin e propozuar të prokurimit para se ZKA i autoritetit kontraktues t'i ketë dorëzuar Zyrtarit Autorizues Deklaratën përkatëse të Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruar nga ZKA dhe ZKF i autoritetit kontraktues sipas paragrafit 5. të nenit 9 të këtij ligji.”

Bazuar në nenet e lartpërmendura, Autoriteti kontraktues ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 43, paragrafi 43.5, pika i, sipas të cilit procedura e prokurimit pas hapjes duhet të anulohet nëse :

“ një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi “

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

